



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1912/1 Prot

Tiranë, më 15/12/2023

VENDIM

Nr.66, datë 15. 12. 2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5, 6, 7, pikës 1 dhe gjurmën c), dh), dhe e) të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me pikën 1 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Komisioneri”) është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji”, si dhe mbështetur në pikën 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, ku parashikohen kompetencat e Zyrës së Komisionerit, ka kryer monitorimin e transparencës proaktive në faqen zyrtare të Autoritetit Publik “Bashkia Divjakë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”), parashikohet se: “Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me

legjislacionin në fuqi...”. Në pikën 3 të nenit 4 të LDI përcaktohet se: “Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik.”.

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore sipas urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha këto autoritete publike, duke filluar data 1 janar 2019.

Programi Model i Transparencës, është hartuar në përputhje me nenin 7 të LDI dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës, ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”.

Bazuar në sa më sipër, gjatë muajit nëntor 2023 Zyra e Komisionerit monitoroi faqen zyrtare të Autoritetit Publik <https://www.bashkiadivjake.gov.al/>, në përfundim të të cilit rezultoi se Autoriteti Publik nuk ka përmbytur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 4, nenin 6 dhe 7 të LDI, për të përditësuar programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr.211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë.

Konkretisht, nga monitorimi i kryer rezultoi se në faqen zyrtare të Autoritetit Publik gjendet i publikuar programi institucional i transparencës sipas modelit të miratuar nga Komisioneri, por jo i përditësuar me informacion sipas fushave dhe rubrikave pjesë përbërëse e tij.

Referuar konstatimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë Autoritetit Publik shkresën nr. 1912 prot., datë 17.11.2023 “*Mbi detyrimet sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të ndryshuar*”, nëpërmjet të cilës, kërkoi marrjen e masave të menjëhershme për publikimin në faqen zyrtare të Autoritetit Publik të të gjitha informacioneve përkatëse në Programin Model të Transparencës. Po ashtu, Zyra e Komisionerit vendosi bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, edhe një raport monitorimi të Programit Model të Transparencës, ku u pasqyruan të gjitha kategoritë e informacioneve që rezultuan të papublikuara në Programin Model të Transparencës së Autoritetit Publik.

Zyra e Komisionerit njoftoi Autoritetin Publik se duke nisur nga data 27 nëntor 2023, do monitorojë sërish faqen zyrtare të tij duke vijuar me procedurën e hetimit administrativ, në përputhje me nenet 18 dhe 19 të LDI.

Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, koordinatori për të drejtën e informimit të Autoritetit Publik ka njoftuar nëpërmjet email-it të datës 24.11.2023, se është njohur me shkresën e Zyrës së Komisionerit dhe ka theksuar se janë duke u kryer të gjitha rregullimet në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Gjithashtu, ka kërkuar edhe që ri-monitorimi i faqes zyrtare të shtyhet për më vonë.

Në vijim të korrespondencës së mësipërme, koordinatori i Autoritetit Publik ka dërguar email në datën 1.12.2023, ku thekson se Autoriteti Publik po vijon të ndërmarrë masa për përmbushjen e detyrimeve sipas LDI. Në këtë komunikim u theksua se: *“Duke patur vështirësi në plotësimin e strukturës së punonjësve kryesisht me IT, ndaj dhe jemi me vonesë për të bërë hedhjen e materialit dhe publikimin (bërjen transparente) për çdo informacion të kërkuar.”*

Lidhur me pretendimet e paraqitura nga koordinatori për të drejtën e informimit të Autoritetit Publik, Zyra e Komisionerit vlerëson se ato nuk qëndrojnë, pasi detyrimi për të bërë publik informacion pa kërkesë sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, të Komisionerit, duhet të zbatohet nga Autoriteti Publik që prej datës 1 janar 2019. Për sa më sipër, është vijuar me ri-monitorimin e faqes zyrtare të autoritetit publik, dhe është konstatuar se Bashkia Divjakë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përditësimin me informacion dhe dokumentacion të Programit të Transparencës.

Referuar pikës 1 të nenit 19 të LDI, përgjegjësia për vënien në zbatim dhe përditësimin e programit institucional të transparencës rezulton e titullarit të autoritetit publik, z. Josif Gorrea.

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI përcaktohet se: *“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” “ç/l”, “h”, “gj”, “m”, “n”, “nj” dhe “o” të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”.*

Në këto kushte, në vijim të kësaj procedure, me qëllim ushtrimin e të drejtës për tu dëgjuar, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet komunikimit me e-mail datë 01.12.2023, drejtuar z. Josif Gorrea, Zyra e Komisionerit njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 07.12.2023.

Pavarësisht njoftimit rregullisht, z. Gorrea në cilësinë e personit përgjegjës pranë Autoritetit Publik, nuk ishte prezent në ditën e seancës dëgjimore, duke mos paraqitur asnjë arsye për mospjesëmarrjen në këtë seancë dëgjimore.

Deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, rezulton se Autoriteti Publik nuk ka të përditësuar kategoritë e informacionit të programit institucional të transparencës sipas parashikimeve të LDI.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumentet zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si autoritete publike, mbartin gjithashtu detyrimin e garantimit të së drejtës për informim, si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre.

LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet publikohet në faqen zyrtare, njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe

afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë atë. Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të LDI.

Nga monitorimi i zhvilluar nga Zyra e Komisionerit dhe hetimi i thelluar më pas, rezultoi se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI, parashikohet ndër të tjera se: *“Titullari i autoritetit publik mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje administrative të parashikuara në shkronjën ç/1 të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”*.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për përditësimin e Programit të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me gjermën “ç/1”, të pikës 2 të nenit 18 të LDI.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në gjermën dh të pikës 2 të nenit 9/1, të gjermës “ç/1”, të pikës 2, të nenit 18, pikën 1 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe gjermën b të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Autoriteti Publik “Bashkia Divjakë”, në zbatim të gjermave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, të përditësojë Programin Model të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të ligjit, duke patur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të këtij ligji, si dhe sipas urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 22. 12.2023.
2. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik, z. Josif Gorrea, Kryetar i Bashkisë Divjakë, në

- cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Bashkisë Divjakë brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, Autoriteti Publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.
 5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ky vendim u shpall sot në datë 15. 12. 2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi